

VENDIM
Nr. 442, datë 11.7.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF 011576 TË FONDIT SUEDEZ TË
MIRËBESIMIT, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE TË
SIGURUARA NGA SUEIDIA, PËR TË FINANCUAR PROJEKTIN E PËRMIRËSIMIT TË
ADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 011576 të Fondit Suedez të Mirëbesimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve të siguruara nga Suedia, për të financuar projektin e përmirësimit të administrimit të burimeve natyrore sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha